



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 22 nëntor 2012

**Nënshkrim i Marrëveshjes financiare IPA 2012 të Programit
për bashkëpunim ndërkufitar me Kosovën (Rezoluta e KB-
së 1244/1999)
(Qeveri, Shkup)**

Fjalim nga

Ekselencia e tij Aivo Orav

Shef i Delegacionit të BE-së

Zëvendëse Kryeministre Arifi,

Zëvendëse Kryeministre Çitaku,

Z. Stock,

Zonja dhe zotëri,

Është nder të jem sot me ju në nënshkrimin e Marrëveshjes financiare për programin ndërkuftar me Kosovën (definuar me Rezolutën e KB-së 1244/1999).

Përvoja e Bashkimit Evropian dëshmon se zhvillimi i rajoneve kufitare është faktor kryesor për integrimin evropian. Instrumenti financiar për bashkëpunim ndërkuftar i zhvilluar nga Bashkimi Evropian kontribuon për tejkalimin e barrierave për **zhvillimin ekonomik dhe social të rajoneve kufitare.**

Megjithatë, bashkëpunimi pa kufi është një proces i vështir dhe rrallë spontan i cili kërkon që të gjithë autoritetet dhe strukturat kompetente të punojnë së bashku ose ti trajtojnë sfidat e përbashkëta.

Edhe kur zgjidhen problemet të trashëguar nga e kaluara, ende mbeten pengesa të mëdha të cilat duhet të tejkalohen. Për shembull, dallimet e institucioneve politike, sistemeve administrative, procedurave, strukturat juridike, standardet teknike dhe të mjedisit.

Me tejkalimin e këtyre pengesave, ata mund të zbatojnë projekte të përbashkëta të cilat i afrojnë njerëzit nga shumë

horizonte të ndryshme. Ata ndihmojnë për ndërtimin e besimit. Këto janë themelet për çdo partneritet afatgjatë dhe përbërës kryesor të integritit evropian.

Bashkimi Evropian financon pesë programe të vendit për bashkëpunim ndërkufitar me fqinjët e saj. Në periudhën 2007 – 2013 mbi 25 milion euro janë ndarë për programet për bashkëpunim ndërkufitar. Me këtë Bashkimi Evropian e thekson angazhimin e tij për zhvillimin ekonomik dhe social të zonave kufitare.

Qëllimi i programit për bashkëpunim ndërkufitar të cilin e nënshkruajmë sot është të promovoj zhvillim të qëndrueshëm të zonave kufitare. Aktivitetet e përbashkëta dhe projektet ndërkufitare do të kenë ndikim mbi gjendjen sociale dhe ekonomike të popullatës, do ta përmirësojë bashkëpunimin e përbashkët dhe vlerësimin e njerëzve, resurset natyrore dhe kulturore dhe do ta forcoj imazhin dhe kohezionin e rajonit.

Për këto tre sfera janë të ndara fondet e BE-së:

1. Zhvillim ekonomik;

2. Zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit; dhe

3. Kohezion social.

Përfituesit potencial të programit do të jenë organizatat jo-profitabile, autoritetet lokale dhe rajonale, asociacionet, fondacionet dhe odat ekonomike.

Unë besoj se këto fonde do të kontribuojnë në zhvillimin e zonave ndërkufitare dhe për të mirën e qytetarëve.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.